

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6522  
E shtunë, 29 janar 2022  
çmimi 0.40

Gjermania e mbështet  
arsimin profesional në  
Kosovë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## RRETH 6 700 NXËNËS AKTIVË ME COVID NË KOSOVË



Zëvendësministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, ka bërë me dije se është rritur numri i nxënësve të infektuar me Covid-19. Maloku-Bërdyna, duke folur për procesin mësimor në shkollat e Kosovës, ka thënë se numri i nxënësve aktivë me Covid është rreth 6 700. Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se varanti "Omicron" i Covidit është duke e rënduar situatën epidemiologjike në vend

### AKTUALE



**DY STUDIME THONË SE DOZAT PËRFORCUESE RITIN MBROJTJEN KUNDËR COVID-19** F. 2

**HOTI: TË NDRYSHOHET VENDIMI QË KËRKON TRI VAKSINA PËR TË HYRË NË KOSOVË** F. 3

**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI KA PRANUAR RRETH 200 ANKESA** F. 7

**Rreziku nga qentë endacakë, kryetari i Prishtinës thotë se duhet bashkëveprim institucional** | FAQE 7



## SOT PROTESTOHET ME MOTON 'JU RRSINI ÇMIMET, NE REZISTENCËN'

Me moton "Ju rrisni çmimet, ne rezistencën", sot (e shtunë) do të mbahet protesta për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike. PSD-ja, partia e cila do ta organizojë këtë protestë, ka bërë me dije se nuk do t'i ndalin protestat dhe

aksionet deri në tërheqjen e propozimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) për shtrenjtimin e rrymës. Lideri i kësaj partie, Dardan Molliqaj, ka ftuar qytetarët dhe aktivistët e të gjitha partive politike që të marrin pjesë në këtë protestë | FAQE 3

### EKONOMI



**BE-ja DHE BERZH-i, NJË MILION EURO ASISTENCË TEKNIKE PËR NDERMARRJET E VOGLA DHE TË MESME** F. 8

**DOGANA: SHBA-ja BËHET TREGU KRYESOR EKSPORTUES I KOSOVËS** F. 8

### SPORT



**PARAQITET EKIPI OLIMPIK I KOSOVËS PËR 'PEKINI 2022'** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Dy studime thonë se dozat përforcuese rritin mbrojtjen kundër Covid-19

**NJU-JORK, 28 JANAR** - Dy studime të reja nga Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar kanë dhënë dëshmi të tjera se dozat përforcuese të vaksinës kundër Covid-19 ulin rrezikun nga hospitalizimet dhe vdekja. Agjencia për Siguri Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar (UKHSA) tha se dozat përforcuese ulin rrezikun e vdekjes nga varianti Omicron për 95 për qind te personat 50 vjeç e më të vjetër. Kjo shifër është më e lartë krahasuar me gjetjet se njerëzit e të njëjtës grupmoshë, që janë të vaksinuar me dy doza, kanë rreth 60 për qind mbrojtje



ndaj vdekjes me Omicron gjashtë muaj pas dozës së fundit. Të dhënat e kësaj agjencie

vazhduan të shfaqin nivele të larta të mbrojtjes kundër hospitalizimeve me 90 për qind

te personat që marrin dozën përforcuese të "Pfizer/BioNTech". "Të dhënat janë të qarta, vaksina ndihmon që të na mbrojtë të gjithë ne kundër efekteve të Covid-19 dhe doza përforcuese ofron nivele të larta të mbrojtjes ndaj hospitalizimit dhe vdekjeve te pjesëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë", ka thënë Mary Ramsay, drejtoreshë për imunizim në UKHSA. Në Shtetet e Bashkuara, Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) ka publikuar një studim të ri ku tregohet se një dozë e tretë e vaksinës "Pfizer/BioNTech" apo

"Moderna" ul në mënyrë të ndjeshme rrezikun nga hospitalizimi në mesin e personave me imunitet të dobësuar. CDC-ja ka njoftuar se studimi gjeti se doza përforcuese ofron 97 për qind mbrojtje te personat pa sëmundje kronike dhe 88 për qind tek ata me sëmundje kronike. Ky studim ishte kryer vitin e kaluar, kur ishte dominues varianti Delta i koronavirusit dhe, po ashtu, sipas CDC-së, është një e dhënë më shumë se doza përforcuese forcon antitruapat te personat me sistem më të fortë imunitar.

## Orban: Duam t'i rritim furnizimet me gaz rus

**BUDAPEST, 28 JANAR** - Kryeministri hungarez Viktor Orban ka thënë të premten se Budapesti do që t'i rritë importet me gazin rus. Këtë kërkesë ai tha se do ta bëjë gjatë bisedimeve me presidentin rus Vladimir Putin javën e ardhshme. "Do të doja ta rritja sasinë e gazit që vjen në Hungari nga nivelet që jemi pajtuar në kontratën për gaz në mes të Rusisë dhe Hungarisë", ka theksuar Orban, i cili ka raporte miqësore me Putinin. Në shtator të vitit të kaluar Hungaria nënshkroi një marrëveshje të re për furnizim

me gaz natyror. Në marrëveshjen me "Gazpromin", kompaninë shtetërore ruse, Hungaria do të marrë 4.5 miliardë metër kubikë gaz çdo vit përmes tubacioneve që anashkalojnë transportin e gazit përmes Ukrainës. Marrëveshja ka kohëzgjatje prej 15 vjetësh. Zyratë ukrainase e kanë kritikuar marrëveshje dhe Ministria e Jashtme ukrainase e ka quajtur këtë si "vendim krejtësisht politik, ekonomikisht të paarsyeshëm dhe në favor të Kremlinit si dhe në dëm të interesave kombëtare të Ukrainës dhe raporteve midis

Ukrainës dhe Hungarisë". I pyetur për tensionet aktuale ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës, që janë nxitur pas dislokimit të mbi 100 000 trupave ruse përgjatë kufirit ukrainas, Orban i tha radios shtetërore se Hungaria "është e interesuar për paqe". Ai shtoi se do të punojë që ta forcojë bashkëpunimin me Rusinë në industrinë e ushqimit, turizmit dhe në hulumtimet hapësinore. Pas përkeqësimit të situatës ekonomike për shkak të pandemisë së koronavirusit, Hungaria do të mbajë zgjedhje



më 3 prill, që priten të jenë një test i fortë për Orbanin dhe partinë e tij të krahut të djathtë,

Fidesz. Orban është në pushtet që prej vitit 2010.

## OKB: Mungesë ekstreme e ushqimit në Tigray të Etiopisë



**ETIOPI, 28 JANAR** - Banorët e rajonit Tigray të Etiopisë "po vuajnë nga mungesa ekstreme e ushqimit", u tha në vlerësimin e ri të Programit për Ushqim të Kombeve të Bashkuara. "Familjet po shterojnë të gjitha mjetet për ta ushqyer vetveten, me tri të katërtën e popullsisë që po përdor strategji ekstreme për të mbijetuar", tha ky program në raportin e publikuar të premten. Në raport u tha se shumica e banorëve po varen vetëm nga

një vakt në ditë. OKB-ja u bëri thirrje të gjitha palëve të përfshira në luftën në Etiopi që të pajtohen për një armëpushim humanitar "dhe zyrtarisht të pajtohen për hapjen e korridoreve të transportit" të ndihmës. OKB-ja tha se asnjë konvoj me ndihma nuk ka hyrë në rajonin Tigray që prej mesit të dhjetorit të vitit të kaluar. Në këtë rajon jetojnë afro gjashtë milionë persona.

Qeveria e Etiopisë po refuzon që të lejojë që ndihma të shkojë në rajonin Tigray pasi ka frikë se ajo mund të bien në dorën e forcave me të cilat po lufton. Që prej nëntorit të vitit 2020 forcat që dikur dominonin qeverinë kombëtare po luftojnë kundër qeverisë aktuale të kryeministrit Abiy Ahmed. Në javët e fundit forcat në Tigray janë tërhequr në këtë rajon pasi tentuan që të avanconin drejt kryeqytetit Addis Ababa.

## Arrestohen 150 persona në Berlin që protestuan kundër vaksinimit të detyrueshëm

**BERLIN, 28 JANAR** - Policia në Berlin ka njoftuar se ka arrestuar rreth 150 persona të cilët protestuan kundër vaksinimit të detyrueshëm kundër Covid-19. Një ditë pas protestës, policia tha se rreth 150 njerëz u mblodhën në tubimin e një organizate e cila përfshin njerëzit skeptikë ndaj koronavirusit e që janë

kryesisht aktivistë të ekstremit të djathtë. Ky grup i aktivistëve ka marrë përsipër organizimin e protestave kundër politikave të qeverisë. Sipas policisë, ka pasur edhe protesta të tjera të shpërndara. Gjatë këtyre protestave policia ka arrestuar rreth 150 persona. Për 32 të arrestuar filluan

hetimet për prishje të qetësisë, rezistencë dhe fyerje ndaj oficerëve. Gjithashtu, oficerët e policisë kanë shqiptuar 108 gjoba ndaj personave që nuk mbanin maska në fytyrë, të cilat janë të obligueshme dhe nuk mbanin distancën e nevojshme. Në këto protesta morën pjesë më pak njerëz sesa pritej.



# Rreth 6 700 nxënës aktivë me Covid në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 JANAR - Zëvendësministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, ka bërë me dije se është rritur numri i nxënësve të infektuar me Covid-19. Maloku-Bërdyna, duke folur për procesin mësimor në shkollat e Kosovës, ka thënë se numri i nxënësve aktivë me Covid është rreth 6 700. "Nga 298 029 nxënës, aktivë me Covid-19 janë 6 687. Në 672 shkolla është duke u zhvilluar mësimi me prani fizike, që i bie se shumica e shkollave ende vazhdojnë të operojnë me skenarin rikthimi", ka deklaruar Maloku-Bërdyna. Zëvendësministrja Maloku-Bërdyna ka thënë se drejtoritë komunale të arsimit kanë raportuar rreth 1 500 raste të mësimdhënësve aktivë me Covid-19. Nga 23 mijë e 90 mësimdhënës, sipas të dhënave që kanë dërguar drejtoritë

komunale, me Covid-19 janë gjithsej 1 489 mësimdhënës", ka thënë Maloku-Bërdyna. Sipas saj, për shkak të rritjes së numrit të rasteve pozitive me Covid-19 në Kosovë, gjithsej 90 shkolla janë duke u zhvilluar mësimin sipas skenarit C, pra mësim online. Ditët e fundit në Kosovë është rritur numri i rasteve pozitive me Covid të grupmoshës 0 deri në 19 vjeç. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të premten nga 13 928 testime, 3 617 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar katër raste të vdekjes. Të premten janë shëruar 1 344 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 164 294. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 31 021. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 4 316 doza të vaksinës kundër Covidit. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 769 170

doza të vaksinës. Deri më sot 804 251 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 72 122 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

Ndërkaq 157 pacientë të konfirmuar me Covid-19 dhe katër pacientë të negativizuar nga Covid janë të shtrirë për trajtim mjekësor në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës. Me oksigjenoterapi janë 108 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive janë të shtrirë tre pacientë.

## IKShPK-ja paralajmëron përkeqësim të situatës me Covid

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se varanti "Omicron" i Covidit është duke e rënduar situatën epidemiologjike në vend. "Omicroni po vazhdon të

përhapet me intensitet të lartë, me shtim të hospitalizimeve, rasteve fatale dhe është varianti dominues në qarkullim që po rëndon gjithnjë e më tepër situatën epidemiologjike dhe mund t'i ngarkojë institucionet shëndetësore në ditët në vijim me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve. Virusit është kudo, andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja. IKShPK-ja ka treguar për simptomat e këtij varianti të Covidit. "Të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen", ka njoftuar ky institut.

Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK-ja u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të respektohen

masat e Qeverisë së Kosovës. "Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim.

U rekomandojmë institucioneve përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19. Omicroni është tejte ngjitës, andaj mbani maskat në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po qe se të gjithë bartin maskë!", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vaksinimi është mënyra më e sigurt për parandalimin e këtij virusi.



## Hoti: Të ndryshohet vendimi që kërkon tri vaksina për të hyrë në Kosovë



PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka reaguar ndaj vendimit të Qeverisë që në Kosovë të mos lejohet hyrja e personave që nuk janë të vaksinuar me dozën e tretë. Hoti ka thënë se është shqetësuese mungesa e koordinimit të qeverisë për marrjen e vendimeve të tilla

me këto vende. "Këto ditë kam pranuar mesazhe dhe thirrje nga Kukësi, Lugina e Preshevës dhe Shkupi e Tetova. Kërkesa për tri doza të vaksinës për të hyrë në Kosovë është vërtet e pakuptimtë. Lëvizjet ditore nga Presheva në Gjilan, apo nga Kukësi në Prizren, janë sikur lëvizjet nga Prizreni në Gjakovë apo nga Gjilani në Ferizaj. Prandaj, çdo vendim që merret duhet parë

si ndikon në jetën e qytetarëve andej kufirit, sepse e kemi obligim shtetëror. Shqetësuese është mungesa e koordinimit të Qeverisë së Kosovës për marrjen e vendimeve të tilla me qeverinë në Tiranë dhe atë në Shkup, si dhe me kryetaren e Preshevës. Ky vendim duhet të ndryshohet menjëherë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".



SOT NË PRISHTINË PROTESTOHET KUNDËR SHTRËNJTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

# Sot protestohet me moton 'Ju rrisni çmimet, ne rezistencën'

Me moton "Ju rrisni çmimet, ne rezistencën", sot (e shtunë) do të mbahet protesta për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike. PSD-ja, partia e cila do ta organizojë këtë protestë, ka bërë me dije se nuk do t'i ndalin protestat dhe aksionet deri në tërheqjen e propozimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) për shtrenjtimit të rrymës. Lideri i kësaj partie, Dardan Molliqaj, ka ftuar qytetarët dhe aktivistët e të gjitha partive politike që të marrin pjesë në këtë protestë

## Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 JANAR - Sot (e shtunë) do të mbahet protesta e parë e PSD-së kundër shtrenjtimit të rrymës. Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, i ka ftuar qytetarët e Kosovës dhe partitë politike që të marrin pjesë në këtë protestë, e cila ka për qëllim ta kundërshtojë propozimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për shtrenjtimit të energjisë elektrike. Në një konferencë për medie ai është shprehur i bindur se vetëm presioni i fuqishëm i qytetarëve mund ta ndalë shtrenjtimit të rrymës. "Ne nesër ftojme secilin qytetar të Republikës së Kosovës, partitë politike dhe organizatat qeveritare, sepse jemi të bindur se një numër i madh i qytetarëve do ta kthejë mbrapa vendimin e ZRRë-së. Protesta është paqësore, por do të kemi edhe aksione simbolike që do ta shprehin revoltën e qytetarëve karshi këtij propozimi të ZRRë-së", ka thënë Molliqaj.

Ai ka thënë se propozimi i ZRRë-së është në koordinim me Qeverinë e Kosovës. "Kemi një propozim nga ZRRë-ja që nuk është i ZRRë-së, por i qeverisë, që është jo vetëm i papranueshëm dhe i padrejtë, por ka shkaktuar edhe një irritim të paparë te qytetarët pasi është shumë i shtrenjtë. Kërkesa e kësaj proteste është që të hidhet poshtë ky propozim i ZRRë-së, sepse ky propozim në njërin anë i favorizon dhe i faktorizon ata të cilët kanë shumë, ndërsa i ndëshkon dhe u qet një barrë shumë të rëndë të tjerëve që janë shumica në këtë vend", ka thënë Molliqaj.

Nëse qeveria nuk reflekton ndaj kërkesave të qytetarëve, ai ka paralajmëruar se protestat dhe aksionet do të vazhdojnë. "Do ta shohim veprimin e qeverisë dhe nëse vendimet janë të njëanshme, prapë nuk na mbetet gjë tjetër vetëm që ne ato t'i kundërshtojmë me aktivitete, aksione dhe protesta të ardhshme", është shprehur ai. Kreu i PSD-së ka vlerësuar se rritja e çmimit të energjisë elektrike

është e papërballueshme për shumicën e qytetarëve, duke shtuar se krahasuar me pagën mesatare, ky çmim është ndër më të shtrenjtë në Evropë. Sipas tij, që prej privatizimit të distribucionit KESCO ka fituar mbi 150 milionë euro.

Ai ka thënë shuma e parave të

ndara nga qeveria për ta mbuluar KESCO-n arrin deri në 120 milionë. Sa i përket trajtimit të veriut për energji elektrike, ai ka thënë se kjo përbën ndarje etnike dhe është në frymën dhe logjikën e Asociacionit.

## Opozita përkrah protestën, por nuk bëhet pjesë e saj

Protestën e PSD-së për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike e kanë përkrahur edhe partitë e tjera opozitare, por ato kanë bërë me

dije se nuk do të marrin pjesë në këtë protestë.

I pari i PSD-së ka treguar se ka takuar përfaqësuesit e këtyre partive për t'u bërë pjesë e protestës. "Jam takuar me Lumir Abdixhikun, Vlora Çitakun dhe Ramush Haradinajn. Ky i fundit ka deklaruar se do ta mbështesë protestën, ndërsa LDK-ja ka thënë se pajtohet me kërkesat tona. PDK-ja ka thënë se ka arsye të protestohet, por nuk do të marrë pjesë", ka deklaruar Molliqaj.

Këtë javë partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, kanë mbajtur një seancë të jashtëzakonshme parlamentare,



# Gjermania e mbështet arsimin profesional në Kosovë

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Gjermania e ka mbështetur arsimin profesional në Kosovë me 3 milionë euro. Këto mjete janë ndarë për bashkëpunimin në mes të shkollave profesionale dhe ndërmarrjeve për ta avancuar arsimin dual. Në ceremoninë e ndarjes, ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci dhe ambasadori gjerman, Jorn Rohde, paraqitën

grantet e para që t'u dorëzohen institucioneve të arsimit profesional dhe ndërmarrjeve të cilat së bashku do të ofrojnë arsim të përshtatshëm profesional, gjatë të cilit nxënësit do të pajisen me shkathtësitë dhe kompetencat në përputhje me nevojat e tregut të punës. Këto bashkime institucionesh kanë aplikuar me sukses në kuadër të Fondit Rajonal të

Sfidave (Regional Challenge Fund - RCF) që mbështetet nga Gjermania përmes Bankës Gjermane për Zhvillim KfW. "Fondi Rajonal i Sfidave është një promotor i shkëlqyeshëm i arsimit dual në Kosovë, i bazuar në modelin e suksesshëm gjerman. Për ekonominë e Gjermanisë bashkëpunimet e tilla të ngushta në mes të ndërmarrjeve dhe institucioneve

të arsimit profesional mbeten esenciale. Ne e mbështetim bashkëpunimin në arsimin dual për ta forcuar ekonominë e Kosovës dhe për të gjeneruar vende pune për të rinjtë në Kosovë", ka theksuar ambasadori gjerman Jorn Rohde. Thirrja e parë e Fondit Rajonal të Sfidave ka tërhequr 205 aplikime të bashkimeve të institucioneve të arsimit profesional nga gjashtë

vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kuadër janë përzgjedhur gjithsej 37 projekte në thirrjen e parë, ndër to gjashtë aplikime të suksesshme nga Kosova. Bashkimet që i kanë fituar grantet do të marrin 3 milionë euro grante për investime në pajisje, infrastrukturë dhe aktivitete të aftësisimit në institucionet e arsimit profesional.



## "Isa Boletini" renditet i dyti në Kosovë nga webometrics sipas citimeve në Google Scholar

MITROVICË, 28 JANAR (ER) - Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM) është renditur i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë sa i përket kriterit të citimeve në Google Scholar në ranglistën e webometrics të shpallur në janar 2022. Në këtë rangim UIBM ka dalë i dyti pas Universitetit të Prishtinës, me 1044 citime.

Rangimi është bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë periudhës 10-20 janar 2022, dhe në versionin e publikuar në webometrics, radhiten vetëm universitetet me mbi 1 000 citime. Në mesin e 4 800 universiteteve botërore, UP-ja dhe UIBM- i janë të vetmet universitete publike në Kosovë që ndodhen në versionin aktual të publikuar.



në të cilën e kanë kundërshtuar propozimin e ZRrE-së. Në fund të debatit parlamentar, ato kanë propozuar një rezolutë, përmes të cilës do të ndalohej rritja e çmimit të energjisë elektrike. Rezoluta nuk është miratuar, sepse deputetët e LV-së nuk kanë

marrë pjesë në votim. Protesta do të mbahet të shtunën, me fillim nga ora 14:00. Kjo protestë me moton "Ju risni çmimet, ne rezistencën" fillon në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë dhe mbaron tek objekti i Qeverisë së Kosovës.

Kjo është protesta e dytë që mbahet për këtë çështje. Në fillim të kësaj jave disa aktivistë të shoqërisë civile kanë mbajtur një protestë duke kundërshtuar propozimin e ZRrE-së. Motoja e kësaj proteste ka qenë "Asnjë cent më shumë".

ZRrE-ja ka propozuar rivendosjen e bllok tarifës deri në 600 KWh për konsumatorët e amvisërisë, si dhe që tarifën e energjisë elektrike të ngritet për 9 për qind për të gjithë konsumatorët komercialë dhe konsumatorët e amvisërisë që konsumojnë deri në 600 KWh,

ndërsa tarifën për konsumin e amvisërisë mbi 600 KWh do të reflektonin çmimin e importit. Kurse Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar t'i ndajë 75 milionë euro për subvencionimin e energjisë për qytetarët dhe bizneset.

## Komuna e Kamenicës pastron rrugët nga bora

**KAMENICË, 28 JANAR (ER)** - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Kamenicë ka pastruar rrugët nga bora në

disa fshatra dhe lagje të kësaj komune. Fshatrat në të cilat ka ndërhyrë kjo drejtori janë:

Viriqec, Lagja Gagict, Desivojcë, Lajçiq, Tërstenë, Kostadincë, Magurë, Gjyrishec, Gmicë, Tugjec.

“Ekipet janë në terren duke punuar për pastrimin e rrugëve”, ka njoftuar komuna e Kamenicës.



## Komuna e Prizrenit mban mbledhje përkujtimore për profesorin Masar Shporta

**PRIZREN, 28 JANAR (ER)** - Nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, është mbajtur mbledhje përkujtimore me rastin e ndarjes nga jeta të profesor Masar Shportës.

Familjarë dhe miq të shumtë të profesorit Shporta evokuan kujtime nga jeta dhe veprimtaria e tij gati njëshekullore e jetës dhe falënderuan kryetarin e komunës për kujdesin e treguar me rastin e organizimit të mbledhjes përkujtimore në nderim të punës intelektuale, kombëtare dhe shoqërore të profesorit tashmë të ndjerë. “Prizreni sot ka humbur një njeri që do të mbetet përherë pjesë e ndritshme e historisë. Humbëm një intelektual atdhedashës, luftëtar të drejtave arsimore e kombëtare shqiptare, ish-i burgosur politik që ishte i gatshëm të flijohet për ideale. Humbëm një qytetar të dashur, të respektuar e një vlerë të madhe të qytetit tonë.

Aktivizmi dhe lufta e tij për të drejtat e arsimit për shqiptarët filloi në vitet e studimeve të tij në Beograd, ku haptas ngriti zërin kundër mohimit të shkollimit në gjuhën shqipe,



kundër regjimit totalitar të Aleksandër Rankoviçit”, ka thënë Totaj, duke shtuar se aktiviteti i tij kundër regjimit të asaj kohe bëri që ai të përndiqej politikisht nga UDB-a dhe të

burgosej nën aktakuzën si kundërshtar i pushtetit serb. “U dënua me gjashtë vjet burgim, u persekutua, u torturua dhe u dërgua në burgun famëkeq të Goli Otokut në Kroaci. Familja e

tij u deportua në Turqi. Pas lirimit nga burgu profesori kurrë nuk u ndal duke kontribuar në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, ishte pjesë e themelimit të shumë

shkollave të mesme e të larta në Kosovë”, ka thënë kryetari Totaj. Në emër të familjes, të pranishmit dhe kryetarin Totaj i ka falënderuar djali i të ndjerit Luan Shporta.

## Nga e hëna qytetarët e Mitrovicës mund t’i marrin vërtetimet pas shërimit nga Covidi



**MITROVICË, 28 JANAR (ER)** - Drejtoria e Drejtorisë së Inspeksionit në Mitrovicë, Valon Brahimi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, Fahri Shabani, kanë pritur të premtën në takim koordinatorin regional të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Mitrovicë, Xhemajl Dervishi.

Qëllim i këtij takimi ishte koordinimi lidhur me lëshimin e vërtetimeve për qytetarët të cilët shërohen nga virusi Covid-19.

Nga ky takim ata u pajtuan që inspektorët sanitarë të AVUK-ut t’i kryejnë shërbimet me vulë dhe protokoll të tyre, ndërsa Drejtoria e Inspeksionit të japë në dispozicion një zyrë në afat prej dymujsh, kurse Drejtoria e Shëndetësisë të përkujdeset për mbikëqyrjen e listës së të shëruarve.


Vërtetimet pas shërimit me virusin Covid-19 qytetarët mund t’i marrin në objektin e komunës së Mitrovicës në katin e katërt.

## Komuna e Gjilanit dhe “Kadri Zeka” nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

**GJILAN, 28 JANAR (ER)**- Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni dhe rektori i Universitetit Publik të Gjilanit, Bajram Kosumi kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Hyseni e Kosumi u zotuan se secila palë do t’i marrë përsipër

përgjegjësitë e veta nga ky memorandum dhe do t’i zbatojnë ato në mënyrë sa më të mirë dhe efikase. “Ne si Komune do të përkrahim Universitetin publik me qëllim të harmonizimit të arsimit të lartë, duke ndërtuar modele konkrete të

bashkëpunimit”, ka thënë kryetari Hyseni. Bashkëpunimi komunë-universitet është një parakusht për sigurimin e suksesshëm të arsimit dhe aftësimin cilësor, për një qytet inovativ e universitet sipërmarrës.



## Rreziku nga qentë endacakë, kryetari i Prishtinës thotë se duhet bashkëveprim institucional

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 28 janar - Të premten është mbajtur takim në mes të përfaqësuesve të komunës së Prishtinës, përfaqësuesve të BE-së, Ministrisë së Bujqësisë, Agjencisë së Veterinarisë (AVUK), OJQ-ve dhe profesionistëve të fushës, ku është diskutuar për shqetësimin e qytetarëve në lidhje me qentë endacakë.

Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se në këtë takim u diskutua për mangësitë në udhëzimin administrativ ekzistues, i cili, sipas tij, duhet përditësuar për t'iu përshtatur situatës në vend. "Shumë qenë fertilë dëbohen nga ekonomitë familjare dhe fermat, duke e rritur kështu numrin e popullatës. AVUK u zotua të kontribuojë me projektin e identifikimit dhe trajtimit, meqë rezultojnë se ka mjaft femra fertile

që duhen sterilizuar, dhe nuk mjafton vetëm kastrimi i qenve meshkuj. U pajtuam se kërkohet një fushatë e organizuar me bashkëpunim mes inspektorëve të veterinarisë së komunave bashkë me AVUK-un në mënyrë që të shtrihet sensibilizimi nëpër zonat rurale", ka thënë Rama pas këtij takimi.

Ai ka shtuar se dyqanet e kafshëve shtëpiake, po ashtu, duhen kontrolluar, kurse pronarët e kafshëve duhet të edukohen mbi pasojat në rast se braktisin qentë në rrugë. "Në rastet kur kërkohet eutanazia e qenve të cilët bartin sëmundje që kanosin shëndetin publik, në përputhje me kriteret e Ministrisë së Mjedisit, duhet të ndahet një sipërfaqe e vogël për varrosjen e organizuar të tyre", ka thënë Rama.

Ai ka treguar se është themeluar tashmë një grup punues për hartimin e planit të veprimit dhe të strategjisë kombëtare për trajtimin human të qenve.



"Strehimorja për trajtimin e qenve endacakë do të krijohet në përputhje me planin fillestar

të kryesisë komunale, sepse aktualisht kemi vetëm qendra për trajtimin e përkohshëm të

kafshëve, që pastaj lirohen prapë", ka deklaruar kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.

## Sindikata e Policisë dhe Qendra për Mjekësi Fizikale 'Nëna Naile' arrijnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri dhe drejtori i Qëndresë për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim banja "Nëna Naile" në Kllokot, Dardan Novosella, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje do t'ua ofrojë mundësinë anëtarëve sindikalë të Policisë së Kosovës që t'i shfrytëzojnë shërbimet e Qëndresë për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim banja "Nëna Naile".

Në këtë marrëveshje janë të përfshira të gjitha shërbimet standarde të Banjës duke filluar nga: kontrolli mjekësor, të gjitha ushtrimet që ua

përcaktojnë mjekët specialistë të fiziatrisë së Qendrës për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim Banja "Nëna Naile" në Kllokot.

Kjo marrëveshje e përbashkët ka për qëllim që shërbimet e Qendrës mund të shfrytëzohen nga anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës, duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga udhëheqja e Sindikatës së Policisë së Kosovës sipas kontratës së re të nënshkruar dje.

Sindikata e Policisë së Kosovës ka theksuar se do të jetë afër çdo zyrtari policor për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për të gjithë anëtarët sindikalë të Policisë së Kosovës.



## Agjencia për Informim dhe Privatësi ka pranuar rreth 200 ankesa

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Agjencia për Informim dhe Privatësi deri më tani ka pranuar 43 ankesa në raport me mbrojtjen e të dhënave personale dhe 147 ankesa të tjera në raport

me qasjen në dokumentet publike, ka bërë me dije Krenare Sogojeva - Demaku, komisionare për Informim dhe Privatësi me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të

Privatësisë. Komisionarja Sogojeva-Demaku ka thënë se kjo ditë ndërkombëtare sot e gjen Kosovën me një agjenci funksionale për qasje dhe mbrojtje të të dhënave personale. Në

anën tjetër, zyrtarë të Këshillit të Evropës në Kosovë kanë kërkuar nga autoritetet kosovare zbatimin e legjislacionit në fuqi për të garantuar të drejtën e mbrojtjes së të dhënave private.



## BE-ja dhe BERZh-i, një milion euro asistencë teknike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 28 janar - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka nënshkruar një paketë të asistencës teknike prej një milion eurosh, e financuar nga Bashkimi Evropian (BE), për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në Kosovë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme tani mund të përfitojnë nga shërbimet këshilluese të përshtatura, të dizajnuara për t'i ndihmuar ato t'i ndërtojnë kapacitetet e tyre të eksportit dhe të kenë mundësi të reja për rritje dhe zhvillim. "Paketa e asistencës teknike është pjesë e Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Ballkanin Perëndimor, përmes të cilit BERZh-i ofron kredi dhe BE-ja kontribuon me grante nxitëse. Edhe pse NVM-të në Kosovë përbëjnë 99.8 për qind të bizneseve të regjistruara dhe pothuajse 80 për qind të punësimit, ato vazhdojnë të përballen me sfida që pengojnë

aftësinë e tyre për të konkurruar në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare", thuhet në njoftimin për medie.

Programi do të fokusohet që t'u ndihmojë NVM-ve për të sjellë në standardet e BE-së kapacitetet e tyre prodhuese, cilësinë e produktit dhe qëndrueshmërinë mjedisore.

Projektet këshillimore do të mbështetjen rimëkëmbjen e SME-ve dhe do t'i ndihmojnë ato ta kompensojnë ndikimin negativ në biznesin e tyre duke i ndihmuar ato të ndërtojnë aftësi kyçe në menaxhim, modele biznesi, komunikim, menaxhim të zinxhirit të furnizimit dhe diversifikimin e shitjeve, ndër të tjera.

Aktivitetet e zhvillimit të tregut dhe sektorit do të implementohen me synimin për të nxitur një mjedis për ndërmarrje, duke ofruar trajnime dhe seminare për ngritjen e kapaciteteve për t'i përmbushur nevojat e ndërmarrjeve dhe konsulentëve, duke ndihmuar në të njëjtën kohë shoqatat e



biznesit dhe sektorit t'u shërbejnë më mirë klientëve të tyre.

Neil Taylor, shef i BERZh-it për Kosovë, ka thënë se bashkëpunimi i vazhdueshëm me BE-në u ka mundësuar të ndihmojnë më shumë ndërmarrës në Kosovë që të ndërtojnë aftësi të reja, të

eksportojnë më shumë dhe të bëhen më të gjelbër. "Nxitja e sektorit privat është prioriteti ynë i parë në strategjinë tonë të re të BERZh-it të miratuar këtë javë", ka pohuar ai.

Ambasadori Tomas Szunyog, shef i Zyrës së BE-së, ka thënë se financimi shtesë për shërbimet këshillimore sinjalizon

mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për NVM-të e Kosovës dhe do t'u mundësojë atyre të bëhen konkurrente në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Kosova u bë anëtare e BERZh-it dhe vendi i operimit në dhjetor të vitit 2012. Që atëherë banka ka investuar 545 milionë euro në Kosovë.

## Spanca dhe Buleshkaj zotohen për bashkëpunim për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit



PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Auditorja e përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, është pritur të premten në takim nga drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Yll Buleshkaj. Me këtë rast, Spanca e ka uruar Buleshkajn për emërimin në krye të AKK-së, duke i dëshiruar suksese në realizimin e objektivave gjatë mandatit të tij.

Gjatë takimit, auditorja e përgjithshme ka shprehur përkushtimin e saj për avancimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në fushat me

interes të përbashkët. "Ky takim ishte një mundësi e mirë që të diskutojmë në terma konkretë bashkëpunimin tonë ndërinstytucional në fushat me interes të përbashkët për Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, me theks të veçantë zbatimin e rekomandimeve të auditimit", është shprehur Spanca.

Gjithashtu, Spanca e ka përgëzuar Buleshkajn dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit për rezultatet e fundit të paraqitura nga Transparency

International ku Kosova është vlerësuar se ka shënuar përparim në luftën kundër korrupsionit.

Ndërsa drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Yll Buleshkaj, e ka njoftuar Spancën për objektivat strategjike me rastin e marrjes së detyrës duke theksuar nevojën e forcimit të bashkëpunimit në fushat e identifikuar me prioritet për AKK-në. Vlora Spanca dhe Yll Buleshkaj janë zotuar për bashkëpunim në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

## Dogana: ShBA-ja bëhet tregu kryesor eksportues i Kosovës

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Në takimin e mbajtur me anëtarët e komiteteve të Odës Ekonomike Amerikane, drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, u shpreh se komunikimi në mes të institucionit që ai drejton dhe bizneseve është gjithmonë i mirëseardhur, duke shtuar që sugjerimet dhe rekomandimet nga ana e bizneseve janë të rëndësishme për këtë institucion.

Drejtori Llugaliu ka theksuar që në vitin 2021 Shtetet e Bashkuara të Amerikës është bërë tregu kryesor eksportues i Kosovës. "Një ndër objektivat kryesore strategjike të doganës

është lehtësimi i tregtisë në të cilin ka pasur përparim të dukshëm vitin e kaluar, por që gjithmonë ka çështje në të cilat duhet fokusuar më tepër", ka thënë drejtori i Doganës, Agron Llugaliu, duke shtuar se Dogana ka për synim vendosjen e standardeve të reja në lidhje me kërkesat e prodhuesve të cilat do të pranojnë përgjigje brenda dy javëve në lidhje me autorizimet.

Sa iu përket investimeve të huaja, drejtori Llugaliu ka pohuar se kohën e fundit po vërehet interesim i madh nga ana e investitorëve të huaj për bashkëpunim me prodhuesit e



Kosovës. Ai ka shtuar se Dogana është në dispozicion dhe e hapur për të gjitha kërkesat në mënyrë që investitorët të mos hasin në


pengesa apo barriera në Kosovë.

Në takim u diskutuan edhe shumë aspekte të rëndësishme në lidhje me aspekte që u

konsideruan thelbësore për operimin e bizneseve, përfshirë edhe shtimin e bashkëpunimit për luftimin e ekonomisë joformale.



# Nga Arkimedi tek Pitagora, fakte të panjohura mbi shkencëtarët më të famshëm të të gjitha kohërave



Ju ndoshta mund t'i njihni emrat e këtyre figurave historike të shkencës, si dhe zbulimet e tyre më të famshme. Por ndoshta mund të mos e dini se ata kanë edhe kontribute të tjera, të cilat kanë ende sot rëndësinë e tyre.

## Arkimedi

Emri i tij lidhet kryesisht me zbulimin e zhvendosjes së ujit, i njohur si Parimi i Arkimit. Kur një objekt futet në ujë, ai shtyn (zhvendos) ujin për t'i bërë vend vetes. Kjo zhvendosje ndodh në një vëllim të barabartë me objektin që zhytet. Por njeriu që konsiderohet si nga shkencëtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, ka zbuluar edhe gjëra të tjera.

Ai shpiku "Kthetrën e Arkimit" ose "dorën e hekurt" për të mbrojtur qytetin sicilian të Sirakuzës nga sulmi armik përmes detit. Ai ishte një lloj sistemi i pompimit të ujit që mund të përdoret ende sot. Ndonëse nuk e shpiku ai levën e parë, Arkimedi e avancoi sistemin dhe shkroi për të në të famshmen "Ligji i levës". Ai llogarit vlerën e saktë më të afërt

të numrit Pi, si dhe kuptoi mënyrën për të llogaritur sipërfaqen e një rrethi. Puna e tij çoi në avancimin e fushës së hidrostatikës dhe llogaritjes.

## Galileo

Galileo Galilei konsiderohet nga shumë njerëz si babai i shkencës moderne, falë kontributit të tij në astronomi, fizikë, kozmologji etj. Edhe pse ishte ai që nuk e shpiku teleskopin, Galilei krijoi një version të përmirësuar, që e rriti shumë zmadhimin. Versioni i tij i krijuar në vitin 1609 ishte aq efektiv saqë çoi në zbulimet e tij më të mëdha.

Galileo ishte personi i parë në histori që regjistroi vëzhgimet e qiellit duke përdorur teleskopin e tij. Ai zbuloi se Jupiteri kishte disa Hëna; se Rruga e Qumështit nuk ishte thjesht

një brez drite, por që përbëhet nga yje të veçantë; fazat e Venusit;

apo faktin që sipërfaqja e Hënës nuk ishte e lëmuar por kishte kraterë dhe male.

Zbulimet e tij ndihmuan për ta vërtetuar se është Dielli dhe jo Toka qendra e Sistemit Diellor, ndaj ai mbështeti modelin Heliocentrik. Po ashtu Galileos i atribuohet projektimi i orës së parë me lavjerrës.

## Da Vinçi

Shumëkush e di se Leonardo da Vinci është autori i tablove të famshme "Darka e Fundit" dhe "Mona Liza". Piktura tjetër e famshme e tij "Salvatore Mundi", u rizbulua në mesin e viteve 2000. Originaliteti i saj ishte dhe mbetet ende një çështje e diskutueshme. Megjithatë ajo vendosi një rekord për veprën më të shtrenjtë të artit në botë, kur u shit për 450 milionë dollarë në vitin 2017. Por ky piktor i Rilindjes kishte aftësi dhe talente të gjera, duke e bërë atë një polimat. Kështu ai ishte arkitekt, hartograf, inxhinier, shpikës dhe skulptor.

Për shkak se shpikjet e tij u bënë shënjës përpara kohës së tyre, ato nuk u realizuan gjatë jetës së tij. Por disa prej tyre pasqyrohen në botën e sotme. Këtu përfshihen parashuta, kostumi i zhytjes

nënujore, mitralozi dhe tanku. Idetë, skicat, shënimet dhe gjetjet e tij ruheshin në fletoret e tij të famshme. Një nga fletoret e tij (i shkruar në vitet 1506-1510) u ble nga Bill Gejts për gati 32 milionë dollarë.

## Fibonaçi

Leonardo Fibonaçi konsiderohet si matematikani më i madh perëndimor i Mesjetës. Ai është i njohur për "Vargun e Fibonaçit", kur dy numrat e mëparshëm mbledhen së bashku për të përcaktuar numrin pasardhës në varg. Modeli numerik që zbuloi ai, gjendet shumë në natyrë, si tek pishat, zgjojet e bletëve, lulet, dhe deri dhe uraganët.

Por ajo që dihet nga pak njerëz, është se ai është autor i futjes së numrave hindu-arab në sistemin evropian. Ai e mësoi sistemin arab, që përdorte numrat nga 0 deri në 9, gjatë kohës që u shkollua në Algeri. Në atë kohë, Evropa përdorte numrat romakë në sistemin e vet, dhe kishte nevojë për numërorë për të bërë llogaritjet.

Ndërsa Fibonaçi e cilësoi më të dobishëm sistemin hindu-arab, italianët dhe Kisha e panë atë me dyshim. Por në fund evropianët u

bindën për epërsinë e tij dhe ajo bë metoda e përdorur në mbarë botën. Fibonaçi krijoi gjithashtu shiritin horizontal të përdorur tek thyesat.

## Pitagora

Pitagora ishte një filozof i lashtë grek, që njihet gjithashtu për kontributin e tij të madh në matematikë: Teorema e Pitagorës, e njohur zakonisht si  $A^2 + B^2 = C^2$ . Në një trekëndësh kënddrejtë, katrori i hipotenuzës është i barabartë me shumën e katrorëve të dy brinjëve të tjera.

Pitagora e pa matematikën kudo, edhe tek muzika, dhe ai ishte përgjegjës për zhvillimin e themeleve të akordimit muzikor. Ai zbuloi konceptin që u bë i njohur si sintonizimi harmonik. Ai është shpikësi i mënyrës se si akordohen ende sot instrumentet muzikore.

Pitagora ishte një figurë me shumë ndikim dhe kishte shumë ndjekës. Ai themeloi një bashkësi filozofike në Kroton, ku jetuan dhe shumë nga ihtarët e tij. Komuniteti përfshinte edhe filozofet gra, gjë që nuk ishte e zakonshme për kohën. / [bota.al](http://bota.al)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Osmani ia dorëzon flamurin ekipit Olimpik të Kosovës: Presim suksese sepse jeni ambasadorët e Kosovës

PRISHTINË, 28 JANAR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ia ka dorëzuar flamurin ekipit olimpik të Kosovës që do ta përfaqësojë vendin në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". E para e vendit ia dorëzoi flamurin skitarit Albin Tahiri, me ç'rast e ka vlerësuar lart punën e bërë nga sportistët. Kosova në Lojërat Olimpikë Dimërore përfaqësohet me dy skitarë profesionistë. Ajo ka shtuar se si Tahiri ashtu edhe Kiana Kryeziu do ta përfaqësojnë Kosovën me nder dhe krenari. "Jam këtu me ekipin e Republikës së Kosovës i cili do të udhëtojë së shpejti për të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë Dimërore. Dua t'i falënderoj që të gjithë për një punë të jashtëzakonshme që kanë bërë, jo vetëm gjatë tërë këtij viti, por për një periudhë të gjatë në mënyrë që tani Kosova të përfaqësohet nga dy skitarë profesionistë, nga Albin Tahiri i cili ka marrë pjesë edhe më parë në Lojërat Olimpikë Dimërore dhe nga Kiana Kryeziu, një 17-vjeçare, e para vajzë e cila merr pjesë në Lojëra Olimpikë Dimërore dhe arrin normën olimpikë. Që të dyja do ta përfaqësojnë Republikën e Kosovës me nder e me krenari

dhe ashtu sikur të gjithë sportistët tanë do të vazhdojnë të jenë imazhi më i mirë i republikës sonë në botë", ka thënë Osmani. Presidentja më tutje ka thënë se presin që këta garues të arrijnë suksese në këtë garë dhe kështu të vazhdojnë të jenë ambasadorët më të mirë të Kosovës në Evropë dhe botë. "Ne natyrisht presim suksesin e tyre, mirëpo vetë përfaqësimi i tyre i deritanishëm është një sukses i jashtëzakonshëm për shtetin tonë sepse sportistët po vazhdojnë të jenë ambasadorët tanë më të mirë në botë edhe në shtetet që nuk na kanë njohur po vazhdojnë ta ngrehin flamurin tonë", ka deklaruar Osmani. Ndërsa presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka thënë me këtë rast se Kosova është bërë pjesë e vetëm 90 shteteve më të mira të botës që merr pjesë në këtë garë në Pekin dhe se të pranohet flamuri nga presidentja e Kosovës është një krenari dhe nder i veçantë. "Është një rast i veçantë dhe një krenari për në që sot e pranuar nga presidentja flamurin kombëtar të Kosovës dhe besoj që me krenari do ta bartin në shtetin që, siç e cekim presidentja, ende nuk e ka njohur Kosovën dhe të tregojmë që edhe



ne kemi garues të vërtetë të cilët, nga shumë shtete të botës, mund të cekim që në 105 shtete të botës nuk kanë marrë norma olimpikë dhe nuk janë pjesë e Lojërave Olimpikë 'Pekini 2022', pra nga e gjithë bota marrin pjesë vetëm 90 shtete. Nga këto 90 shtete të forta dhe nga kjo konkurrencë shumë e madhe i kemi edhe dy sportistë

nga Kosova që do të marrin pjesë dhe do ta përfaqësojnë Kosovën në mënyrë më të mirë të mundshme", ka deklaruar Krasniqi. I nderuar me këtë pranim të flamurit u shpreh edhe skitari Albin Tahiri i cili shkurtimisht tha se flamurin e Kosovës e ka në zemër dhe e tregon me krenari.

"Faleminderit presidente! Unë jam shumë krenar. Unë nuk e tregoj flamurin e Kosovës vetëm me dorë, por unë e tregoj flamurin e Kosovës edhe me zemër. Faleminderit shumë!", ka thënë Tahiri. Lojërat Olimpikë Dimërore do të zhvillohen nga data 4 deri më 20 shkurt.

## Paraqitet ekipi olimpik i Kosovës për 'Pekini 2022'



PRISHTINË, 28 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) të premten e ka paraqitur ekipin olimpik të Kosovës që do të udhëtojë për pjesëmarrje në

Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Kosova do të marrë pjesë me dy garues në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022" dhe këtë e ka

konfirmuar presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi. Ky i fundit në konferencën e mbajtur ka bërë paraqitjen e ekipit olimpik të Kosovës, e cila për herë të parë

merr pjesë me dy sportistë. "Është hera e dytë që marrim pjesë në këto lojëra. Albin dhe Kiana do të na përfaqësojnë në këto lojëra që janë të rëndësishme. Albin garon në katër disiplina, kurse Kiana në sllallom të madh dhe është femra e parë nga Kosova në këtë ngjarje", ka thënë fillimisht Krasniqi në konferencë. "Ndihe mi krenar që jemi në mesin e 90 shteteve pjesëmarrëse duke pasur parasysh që 105 shtete nuk

kanë arritur normën. Kjo është një arritje e madhe për ne". "Detaj tjetër i rëndësishëm është se flamurin në ceremoninë hapëse do ta bartë Albin Tahiri. Pritjet tona në Pekin nuk janë sikurse ato në Tokio, kur dihet se konkurrenca e fortë është në skijim. Një renditje e mirë e garuesve do të jete sukses i madh për Kosovën. Ekipi niset nesër, kurse pjesa tjetër më 2 shkurt", ka përfunduar presidenti i KOK-ut.

## Rrahmani: Po të isha italian, të gjithë do të flisnin për mua

NAPOLI, 28 JANAR - Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, është përshtatur mjaft mirë te Napoli, duke e "blinduar" pozitën e titullarit. Madje ai hyri në formacionin e muajit në Serinë A falë paraqitjeve mbresëlënëse. Mbrojtësi Rrahmani ka folur për mediet italiane duke përmendur

të kaluarën, të tashmen dhe synimet që ka me Napolin. "Gjithmonë kam thënë që po të isha italian do të kishin folur të gjithë për mua. Me sa duket kombi im nuk është i famshëm për futbollin, do të thotë që duhet të punoj edhe më shumë që t'i detyroj kritikët të më ndjekin", ka thënë Rrahmani.

"Unë jam trashëgimtari i Koulibaly? Është një përgjegjësi e madhe sepse Koulibaly është Koulibaly. Ai është lideri. Por nëse do të ndodhte, nuk do të kishte probleme. Kur rritem, përgjegjësitë rriten, prandaj jam gati. Për mua do të ishte një privilegj", ka deklaruar Rrahmani.



## Nadal - Medvedev, finalja e Australian Open

MELBOURNE, 28 JANAR - Tenisti spanjoll Rafael Nadal dhe ai rus Daniil Medvedev do ta diskutojnë finalen e Australian Open. Në gjysmëfinalen e parë Nadal triumfoi 3-1 ndaj italianit Matteo Berrettini. Spanjollit fitoi 6-3 dhe 6-2 dy setet e para,

ndërsa Berrettini rihapi ndeshjen pas triumfit 6-3 në setin e tretë. Gjithsesi, Nadali tregon forcën në setin e katërt, duke fituar 6-3. Rafael Nadali e ka fituar vetëm një herë këtë turne, në vitin 2009 dhe tashmë synon triumfin numër 21 në një

grand slam, që do të ishte rekord. Edhe Federeri me Djokoviqin kanë fituar nga 20 grand slame. Edhe gjysmëfinalja tjetër përfundoi 3-1. Rusi Medvedev, numri 2 në botë, triumfoi ndaj grekut Tsitsipas. Seti i parë u fitua me shumë

vështirësi nga Medvedev 7-6, të dytin e mori greku 6-4, pastaj rusi fitoi dy të tjerët 6-4 dhe 6-1. Në finalen që do të luhet të dielën në Melbourne, pritet një përballje e fortë. Nëse triumfon Medvedevi, bëhet



numri një në botë, duke zbritur nga froni Djokoviqi.

## Tri ndeshje interesante në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 28 JANAR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 18-të në Art Motion Superligë, që do të dhurojë ndeshje shumë interesante. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Prizrenit 16 dhe Dritës, ku prizrenasit janë favoritë, pasi kanë dhjetë fitore e pesë humbje, kurse gjilanasit kanë 17 humbje në po kaq ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në elitë.

Ndeshje më interesante pritet në mes të Rahovecit dhe Bashkimit. Vreshtarët kanë katër fitore dhe 11 humbje, ndërsa prizrenasit tetë fitore



dhe nëntë humbje. Fitorja është e rëndësishme për të dyja skuadrat, andaj pritet një përballje interesante. Të dielën pritet një sfidë shumë interesante mes rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës, Trepçës dhe Pejës, ku të dyja skuadrat kanë nga 11 fitore e gjashtë humbje. Të dyja

skuadrat kanë ambicie të mëdha në këtë edicion. Përballje me interes pritet edhe në mes të Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës, kampionit dhe fituesit të Kupës së Kosovës. Ylli është në formë të lartë, pasi numëron 13 fitore dhe katër humbje, kurse prishtinasit kanë nëntë fitore dhe tetë humbje.

### SUPERLIGA - JAVA 18

TË SHTUNËN TAKOHEN:  
17:00 PRIZRENI 16 - DRITA  
19:00 RAHOVECI - BASHKIMI

TË DIELËN TAKOHEN:  
17:00 TREPÇA - PEJA  
19:00 GOLDEN EAGLE YLLI - SIGAL PRISHTINA

## Derbi në mes të Bashkimit dhe Penzës

MITROVICË, 28 JANAR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 13-të në Superligën e Femrave. Derbi do të zhvillohet në mes të Bashkimit dhe Penzës të shtunën dhe transmetohet në "Art Motion" dhe "Kujtesa". Ndeshja do të zhvillohet në Rahovec, pasi palestra në Prizren është shumë e ftohtë dhe klubet prizrenase ndeshjet si vendase po i zhvillojnë në qytetet e tjera. Vashat prizrenase kanë tetë fitore dhe katër humbje, kurse ato pejane kanë dhjetë fitore e dy humbje. Në këtë edicion të elitës, në dy ndeshje, fitore ka shënuar



skuadra kampione (Penza) me rezultat 63:84 dhe 77:68. Sidoqoftë, skuadra prizrenase ka bërë disa përforsime dhe pritet ndeshje interesante. Të shtunën zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Trepçës dhe Kastriotit. Vashat mitrovicase kanë tri fitore e nëntë humbje, ndërsa ato

ferizajase kanë pësuar 12 humbje në po aq ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme pa fitore. Ndërkohë, skuadra e vetme pa humbje në elitë, Prishtina, me 12 fitore në 12 ndeshje, do të jetë mysafire e Vëllaznimit, ndërkohë që skuadra kuqezi ka tri fitore dhe nëntë humbje.

### SUPERLIGA E FEMRAVE - JAVA 13

TË SHTUNËN TAKOHEN:  
14:00 TREPÇA - KASTRIOTI  
16:00 BASHKIMI - PENZA

TË DIELËN TAKOHEN:  
13:00 VËLLAZNIMI - PRISHTINA

## Gosens: Kam ardhur në një nga ekipet më të mëdha në Evropë

Robin Everardus Gosens është edhe zyrtarisht futbollist i Interit. Ai është transferuar në formë huazimi me obligimin e blerjes gjithmonë nëse

plotësohen kushtet në marrëveshjen e arritur me Atalantën. Gosens do ta veshë fanellën me numrin 18 në skuadrën kampione të Italisë. "Është një krenari e

madhe sepse kam ardhur në një nga ekipet më të mëdha në Evropë. Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe me të vërtetë mezi pres të filloj", ka thënë Gosens.

Futbollisti gjerman foli edhe për trajnerin Simone Inzaghin. "Po, folëm mbrëmë në një video-telefonatë. Ai më tha se çfarë pret nga unë dhe unë i

tregova pak për idetë e mia. Kemi një dëshirë të madhe për të punuar së bashku dhe mezi pres të jem në fushë me të dhe me ekipin", ka shtuar Gosens.

### SHKURT

#### Toma transferohet te St Galleni

Mesfushori shqiptar Bastien Toma ka kompletuar huazimin e tij në St Gallen nga klubi belg Genk. Afati kalimtar i janarit ka bërë që edhe disa futbollistë shqiptarë ta ndryshojnë ambientin. Një nga ta padyshim se është mesfushori 22-vjeçar Bastien Toma, i cili ka kaluar te St Gallen në huazim. Është vetë klubi zviceran i cili ka konfirmuar huazimin e shqiptarit nga Genku. "Mirë se vini në Sangalla, Bastien Toma! Ne e marrim në huazim hua mesfushorin 22-vjeçar Bastien Tom nga KRC Genk deri më 30 qershor 2022", thuhet në njoftim.

#### Golden State triumfon ndaj Minnesotas

Dy ndeshje janë luajtur në NBA. Skuadra e Golden States fitoi me rezultat 124-115 ndaj Minnesotas, ndeshje e dominuar dhe fituar me meritë nga Warriorsi. Curry me 29 pikë dhe Thompsoni me 23 bënë diferencën në fushë për vendasit (splash brothers), duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Townsit për miqtë. Në anën tjetër, zhgënjën sërish ekipi i lakersave, që u mund me rezultat 105-87 nga Philadelphia. Një nga ndeshjet më të dobëta të lakersave (Davis 31 pikë e 12 rebounde), ku u ndie mungesa e LeBron Jamesit. Për Philadelphian u dalluan Embiid me 26 pikë dhe Harrisit me 23 pikë.

#### Kroos: Ramosi ka qenë me shumë se një shok

Mesfushori i Realit të Madridit, Toni Kroos, gjatë një interviste për televizionin spanjoll "TVE", ka folur për duelin e Realit në Ligën e Kampioneve përballë Paris SG-së. Mesfushori gjerman ka komentuar edhe përballjen me Ramosin, i cili tash është pjesë e skuadrës franceze. "E kam thënë dhe më parë se do të jetë një përballje e fortë. Është shumë e rëndësishme që të arrijmë në formën e duhur në këto përballje. Pastaj fusha do ta tregojë se kush është më i miri. Sa për përballjen me Ramosin do të jetë diçka e veçantë. Për ne ai ka qenë një shok edhe më shumë, ka qenë një kapiten. Do të jetë pak e çuditshme të jemi përballë në fushë, sepse ishim mësuar të ishim në të njëjtën anë", ka thënë Kroos.

#### Kahn: Lewandowski ta harrojë largimin nga Bayerni

Robert Lewandowski është prej vitesh një garanci golash për Bayern Munchenin. Sulmuesi polak ka kontratë deri në vitin 2023 me rekordmenët e futbollit gjerman. Drejtuesit e Bayernit duan të rinovojnë me polakun dhe një gjë të tillë e shpreh presidenti Oliver Kahn, i cili thur elozhe për 33-vjeçarin në deklaratën e dhënë për mediet gjermane. "Lewandowski është një fenomen absolut jo vetëm për golat që shënon vazhdimisht, por edhe për faktin që ka ruajtur një nivel të lartë loje me kalimin e viteve. Ne do të tentojmë ta mbajmë në skuadër. Stili i tij i futbollit është garanci për ne. Ne do të bëjmë gjithçka që Roberti të qëndrojë te Bayerni për aq kohë sa të jetë e mundur", ka deklaruar drejtori i klubit gjerman.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**DREJTORIA E ARSIMIT**  
05nr.81 datë 28.01.2022

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm),UA MASHI nr.08/2021, Udhezimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall dhe rishpall:

**KONKURS**  
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. SHFMU "Shkëndija"-Suharekë
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe
2. SHFMU "Dëshmorët e Greikocit"-Greikoc
  - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
3. SHFMU "Besim Ndrecaj"-Maçiteve
  - Një edukatore për paralelen parashkollore (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
4. SHFMU "Bajram Curri"-Nishor
  - Një edukatore për paralelen parashkollore
5. SHFMU "Dëshmorët e Kombit"-Vraniq
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e edukatës fizike për 12 orë
6. SHFMU "Naum Veqilharxhi"-Mohlani
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e TIK-ut me plotësim orësh në shkollat tjera
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e edukatës muzikore për 16 orë mësimi (4 orë në Mohlan, 4 orë në Kruhicë të epërme, 4 orë në Doberdelan dhe 4 orë në Semetište)
7. SHFMU "Dituria"-në Samadrxhë
  - Një punëtor teknik-ndihmës
  - Një punëtor teknik-ndihmës për kohë të caktuar deri më 31.05.2022 (zëvendësim)
8. SHFMU "Vaso Pashë Shkodrani"-Leshan
  - Një punëtor teknik-ndihmës -rishpallje
9. IP "Fluturat"-Suharekë
  - Një kuzhinier/e për paralelen në Duhël-rishpallje

**Kushtet:** Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHI nr.05/2021 dhe UA-MASHI nr.08/2021.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI (nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

**Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.**

Drejtori i DKA-së  
Remzi Bajselmani

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE**  
05 br. 81 od 28.01.2022 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068, AI br.05/2021 (Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), UA.MONT-a br.08/2021, Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru, Opština direkcija za obrazovanje objavljuje i novo obavljuje:

**KONKURS**  
Za popunu slobodnih radna mesta

1. OSNSH "Škendija"-Suva Reka
  - Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika
2. OSNSH "Deshmoret e Greikocit"-Greikovec
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
3. OSNSH "Besim Ndrecaj"-Maçiteve
  - Jedan nastavnik/ca za predškolskog obrazovanje (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
4. OSNSH "Bajram Curri"-Nishore
  - Jedan nastavnik/ca za predškolskog obrazovanje
5. OSNSH "Deshmoret e Kombit"-Vraniče
  - Jedan nastavnik/ca za predmet fizička vaspitanje za 12 časova
6. OSNSH "Naum Veqilharxhi"-Movlane
  - Jedan nastavnik/ca za predmet TIK
  - Jedan nastanik/ca za predmet muzičkog vaspitanja za 12 časova (4 časova u Movlane, 4 časova u Kruhice, 4 časova u Doberdelane, 4 časova u Semetište).
7. OSNSH "Dituria"-Samadrxhe
  - Jedan tehnički / pomoćni radnik
  - Jedan tehnički / pomoćni radnik na određeno vreme do 31.05.2022-zamena
8. OSNSH "Vaso Pashë Shkodrani"-Leshane
  - Jedan tehnički / pomoćni radnik -novo obavljjenje
9. Dečji vrtić "Fluturat"-Suva Reka
  - Jedan kuvara/ica za odeljenje u Duhle- novo obavljjenje

**Uslovi:** Za ova slobodna radna mesta obavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021 i AU mont BR.08/2021

**Dokumentacija potrebna za konkurs:**

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
- Ekstrakt rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
- Dokaz da nije pod istragom
- Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano, dok će se originalni dokumenti predstavljavati u intervju. Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka. Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

**Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od obavljenu u novinama**

Orasporedu intervju bićete obavješteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Avdyll Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" Llukar KK Prishtinë.
- ▶ "Rima Engineering Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 71169790 si dhe nr fis: 601268718.
- ▶ Ardian Gashi Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Sinavere Halimi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Samidin Emini " Kuk.
- ▶ Azar Kapllani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Arben Hashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Valdete Olloni Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- ▶ Florid Kurhaski Crmjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Ali M Hasi" nga kl. I, V dhe VI-IX.
- ▶ Esat Shala shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.T. "Arkitekt Sinani" (ish Boris Kidric).
- ▶ Valentina Krasniqi shpalle te pavlefshme dëftesat, diplomën d he certifikatën e ShMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ Valbone Catovic shpalle te pavlefshme diplomën me numër 096/19 te lëshuar nga qendra Diakonie Training Center.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 2188/05

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Muhamet Zenelaj nga Theranda, Lagja e Re, Rruga, "Bedri Peja", nr. 15, të cilin në bazë të autorizimit i përfaqëson Sadije Mjekiqi, avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Milena Lekiq, nga Prishtina, tani me adresë të panjohur, në çështjen juridike kontestimore vërtetim i pronësisë, jashtë seance, me datë 20.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurës Milena Lekiq, nga Prishtina, tani me adresë të panjohur, i CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm, Rrahman Kastrati, avokat nga Prishtina.

Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurës, deri në momentin kur e paditura të paraqitet personalisht në gjykatë, të caktojë të autorizuarin e saj, apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë-Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, i cakton kujdestarin.

Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala paditëse.

Ky aktvendim do të publikohet në mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate, Gazetën Zyrtare, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurës, të autorizuarit të paditësit dhe Organit të Kujdestarisë.

A r s y e t i m

Pran kësaj gjykate është iniciuar kontesti për vërtetimin e pronësisë, sipas shenjës C.nr.2188/05, me palë paditëse Muhamet Zenelaj nga Theranda, Lagja e Re, Rruga, "Bedri Peja", nr. 15, të cilin në bazë të autorizimit i përfaqëson Sadije Mjekiqi, avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Milena Lekiq, nga Prishtina, tani me adresë të panjohur.

Gjykata të paditurës Milena Lekiq ish nga Prishtina, tani me adresë të panjohur nuk ka mundur t'i dorëzoj aktvendimin për përgjigje në padi dhe padinë së bashku me provat e bashkangjitura në padi, si dhe ftesën për seancë gjyqësore, pasi që adresa e kësaj të paditurore nga padia ka rezultuar si e pa njohur dhe gjykata nuk ka mundur të komunikoj me te.

E autorizuar e paditësit në seancën gjyqësore të datës 23.03.2021, i ka propozuar gjykatës që të paditurës Milena Lekiq t'i caktoj përfaqësuesin e përkohshëm në kuptim të dispozitave të LPK-së, pasi që adresa e saj është e pa njohur.

Gjykata me kërkesën e datës 24.03.2021, ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencioni i Regjistrimit Civil adresën e të paditurës Milena Lekiq, pasi që adresa e kësaj të paditurore është e panjohur, mirëpo Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencioni i Regjistrimit Civil në përgjigjen e saj të datës 24.03.2021, ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë e dhënë për të paditurën Milena Lekiq, duke kërkuar numrin personal, por gjykata nuk ka të dhëna tjera për këtë të paditur.

Gjykata në pamundësi për të siguruar adresën e të paditurore e me propozimin e të autorizuarës së paditësit me datë 18.01.2022, ka kërkuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës që lidhur me këtë çështje civilo-juridike të caktoj një avokat nga radha e avokatëve të regjistruar pranë kësaj ode.

Me parashtresën e datës 20.01.2022, Oda e Avokatëve të Kosovës i është përgjigjur gjykatës në kërkesën për përfaqësues të përkohshëm dhe ka caktuar Rrahman Kastrati, avokat në Prishtinë.

Mbi këto arsye dhe sipas propozimit të autorizuarës së palës paditëse gjykata ka vendosur që të paditurës Milena Lekiq, t'i caktoj përfaqësuesin e përkohshëm Rrahman Kastrati, avokat nga Prishtina, pasi që në rastin konkret nuk dihet adresa e të paditurore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos në kuptim të nenit 79,3 germa (a), nenit 81,82 dhe 83 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.2188/05, dt. 20.01.2022.

KËSHILLË JURIDIKE:

kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.br.2188/05

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI- Opšti Departman, sudija Ylber Shurdhiqi, u spornoj pravnoj stvari tužiocu Muhamet Zenelaj iz Suvereke, Novo Naselje, Ul."Bedri Peja", br.15, kojeg na osnovu punomoćja zastupa Sadije Mjekici, advokat iz Prištine, sada s nepoznatom adresom, u spornoj pravnoj stvari potvrđivanje svojine, van ročišta, dana 20.01.2022 godine, donoe ovo:

R E Š E N J E

Tuženoj Mileni Lekić, iz Prištine, sada sa nepoznatom adresom, ODREĐUJE SE privremeni zastupnik, Rrahman Kastrati, advokat iz Prištine.

Privremeni zastupnik ima sva ovlašćenja u ovoj stvari, da preduzme sve pravne radnje da bi branio interese tužene, do trenutka kada se tužena predstavi lično u sudu, da odrede njenog punomoćnika, ili do trenutka kada organ starateljstva-Centar za Socialni Rad u Prištini, odredi starateljstvo.

Troškove za privremenok zastupnika snosi tužioc.

Ovo rešenje će se objaviti u javnim medijima, oglasnu tablu ovog Suda, Službeni List, takođe dostavlja se i privremenom zastupniku tužene, punomoćniku tužiocu i Organu Starateljstva.

O b r a z l o ž e n j e

Pri ovom sudu iniciran je spor za potvrđivanje svojine, pod oznakom P.br.2188/05, sa tužiocem Muhamet Zenelaj iz Suvereke, Novo Naselje, Ul."Bedri Peja", br.15, kojeg po punomoćju zastupa Sadije Mjekiqi, advokat iz Prištine, protiv tužene Milena Lakić, iz Prištine, sada sa nepoznatom adresom.

Sud tuženoj Mileni Lakić iz Prištine, sada sa nepoznatom adresom nije mogao da dostvi rešenje za odgovor na tužbu i tužbu zajedno sa dokazima priloženim u tužbi, kao i poziv za sudsko ročište, pošto adresa ove tužene iz tužbe proizlazi nepoznata i sud nije mogao da snjom komunicira.

Punomoćnik tužiocu u sudskom ročištu od dana 23.03.2021 godine, predložio je sudu da tuženoj Mileni Lakić odredi privremenog zastupnika u smislu odredaba ZPP, pošto njena adresa je nepoznata.

Sud zahtevom od dana 24.03.2021 godine, zatražio od Ministarstva Unutrašnjih Poslova-Agencija za Civilnu Registraciju adresu tužene Milene Lekić, pošto adresa ove tužene je nepoznata, ali Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Agencija za Civilnu registraciju u njenom odgovoru od dana 24.03.2021 godine, konstatovao je da nije naden ni jedan podatak za tuženu Milenu Lakić, zatražujući lični broj, ali sud nema drugih podataka za tuženu.

Sud u nemogućnosti da obezbedi adresu tužene i sa predlogom punomoćnika tužiocu dana 18.01.2022 godine, zatražio je od Advokatske Komore Kosova da u vezi ove pravne stvari odredi advokata iz redova advokata upisani pri ovoj komori.

Podneskom od dana 20.01.2022 godien, Advokatska Komora Kosova odgovori je sudu na zahtv za privremenog zastupnika i odredio je Rrahman Kastratia, advokat u Prištini.

Nad ovim razlozima i po predlogu tužiocu sud je odlučio da tuženoj Mileni Lakić, odredi privremenog zastupnika Rrahman Kastratia, advokat iz Prištine, budući da u konkretnom slučaju ne zna se adresa tužene.

Iz gore navedenih, odlučilo se u smislu člana 79,3 slovo (a), člana 81,82 I 83 Zakona O Parničnom Postupku.

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI- Opšti Departman,

P.br.2188/05, od dana 20.01.2022 godine

Sudja ,  
Ylber Shurdhiqi

PRAVNA POUKA:

Protiv ovog rešenja nije dozvoljena žalba.

Prevela: Bleria Bekteshi



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




## PASHTETË PULE

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues